



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
HEC LANABREGAS SH.A



## Shtojca 12

### FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

[05/05/2022]

Drejtuar: “*MUHOPLUS LTD*” SHPK

Me adrese: “*Rruga Ded Gjo Luli, Pallati Nr.2, Shkalla 2, Tirane*”

Procedura e prokurimit/lotit: E hapur

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-23771-04-01-2022

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “*Rikonstruksioni i Seksionit 6KV*”, Kohëzgjatja në muaj 4 (kater) nga dorezimi i sheshit.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomike më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. “*A&E*” sh.p.k

K49322502N

Vlera e ofertës pa tvsh është 10,040,622.5 (dhjetë milion e dyzet mijë e gjashtëqind e njëzet e dy pike pese) lekë.

2. *“EV Engineering ” Sh.p.k*

*L91311033Q*

Vlera e ofertës pa tvsh është 13,371,150.1 (trembedhjetë milion e treqind e shtatëdhjetë e një mijë e njëqind e pesëdhjetë pike një) lekë.

3. *“RAFIN COMPANY ” Sh.p.k*

*L52125110A*

Vlera e ofertës pa tvsh është 13,636,427 (trembedhjetë milion e gjashtëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e katërqind e njëzetë e shtatë) lekë.

4. *“MUHOPLUS LTD ” Sh.p.k*

*L52317046G*

Vlera e ofertës pa tvsh është 14,727,060 (katërmbedhjetë milion e shtatëqind e njëzet e shtatë mijë e gjashtëdhjetë) lekë.

#### **Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:**

1. *“A&E” sh.p.k*

*K49322502N*

Në shtojcën 8 të vetdeklarimit pika 6 dhe 7 e seksionit II/B OE ka deklaruar me "PO" në të dy rastet, duke rënë ndesh me njëra tjetren dhe duke mos treguar se në cilin prej rasteve ndodhet OE.

Nuk plotëson kriterin 2.3.2: OE nuk ka paraqitur CV të kërkuara për 3 Elektricitet. Paga në kontratat e punës së stafit nuk është në të njëjtën vlerë me ato të listepagesave.

OE ka paraqitur kontratë pune dhe dëshmi të sigurimit teknik por nuk ka paraqitur për to CV sikurse është kërkuar nga AK në pikën 2.3.2 të dst. Gjithashtu nga dokumentacioni i paraqitur në spe nga OE përkatësisht listepagesat E-sig për periudhën dhjetor 2021, janar 2022 dhe shkurt 2022, vëhet re se kontrata e punës së lidhur për Drilon Pjetri, Ismet Lami dhe Marash Mexhaj në pozicionin e elektricitetit mbajnë datën 01.01.2022, gjë e cila tregon se marrëdhëniet e tyre të punës ka filluar efektet, por punëmarresit të sipërcituar nuk figurojnë në listepagesat për muajin janar 2022 dhe figurojnë vetëm 3 ditë të paguara për muajin shkurt 2022 edhe pse efektet financiare të tyre për një punë me kohë të plotë kanë nisur prej 01.01.2022. Gjithashtu për punëmarresin Drilon Pjetri i punësuar sipas kontratës së punës me pozicionin "Elektricitet", sipas listepagesës së muajit shkurt 2022, i paguar vetëm për 3 ditë pune, është i deklaruar me kodin 9622.03 "Punëtor ndihmës" dhe jo me kodin 7411.01 "Elektricitet"

OE nuk permbush plotesisht piken 2.3.5 te KRITEREVE TE VECANTA TE KUALIFIKIMIT. Dokumentet nuk jane te perkthyer, celat e ofertuara nuk plotesojne specifikimet teknike: Tipi i celes eshte kerkuar: Celat duhet te jene me celes karroce dhe me rele mbrojtese qe te kene mundesi lidhje me SCADA sipas protokollit te komunikimit IC 61850.; Celat e ofertuara nuk kane celes karroce, nuk kane rele dhe nuk kane mundesi komunikimi me SCADA sipas potokollit te komunikimit IEC61850. Celat e ofertuara jane cela kabine, jo cela nenstacioni dhe nuk i plotesojne specifikimet teknike te kerkuara. Qendrueshemria ndaj rrymes per kohe te shkurter e kerkuar: 31.5kA per celat furnizuese, ndersa per celen e TRNV eshte 6.3KA, OE nuk e ploteson. Dokumentet e paraqitura per Transformatore fuqie 250 kVA 6.3/0.4kV, nuk jane te perkthyer ne gjuhen shqipe. Dokumentet e paraqitura per Celat mate/mbrojtje 6.3 kV 630 A, nuk jane te perkthyer ne gjuhen shqipe. Dokumentet e paraqitura per Kabell XLPE 6.3kV Cu (1x70) mm<sup>2</sup>, i nuk jane te perkthyer ne gjuhen shqipe. Dokumentet e paraqitura per Kabell ushqimi, kontrolli, nuk jane te perkthyer ne gjuhen shqipe. Dokumentet e paraqitura per Terminale 1 fazore 6.3kV, nuk jane te perkthyer ne gjuhen shqipe.

Nga shqyrtimi i ofertes u konstatua se: Ne zbatim te KRITEREVE TE PERGJITSHME TE PERZGJEDHJES, "Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip"

Autoriteti kontraktor e ka te pamundur te verifikojte plotesisht dhe ne menyre te sakte parametrat teknik te ofertuar per paisjet e mesiperme.

OE nuk permbush piken 2.3.5/5 te KRITEREVE TE VECANTA TE KUALIFIKIMIT, nuk ka paraqitur skeda teknike per kabllot e ushqimit. Nuk ka paraqitur skede teknike per celat ku tregohen parametrat e detajuara, eshte paraqitur vetem vizatim. Nuk ka paraqitur skede teknike per kabllin 6.3kV 1x70mm<sup>2</sup>.

Per kete arsye KVO vendosi te mos pranoje oferten e OE "A&E "shpk.

## **2. "EV Engineering " Sh.p.k**

**L91311033Q**

OE ka paraqitur vetem cv dhe deshmine e kualifikimit, por nuk ka paraqitur kontrate pune per elektricistet sikurse eshte kerkuar nga AK ne piken 2.3.2 te dst.

OE nuk permbush piken 2.3.5 te KRITEREVE TE VECANTA TE KUALIFIKIMIT:

1. per terminalin 1 fazor, eshte paraqitur katalogu dhe skeda teknike per tipin 3x1x25÷95mm<sup>2</sup>, ndersa test raporti eshte paragitur per tip tjetër terminali, perkatesisht: 1x95÷240mm<sup>2</sup>. Nuk mund te vertetohet perputhshmeria teknike e katalogut, skedes teknike me test raportin e paraqitur;
2. per kabllin e fuqise nuk eshte paraqitur test raport. Operatori ekonomik nuk ka paraqitur skede teknike per kabllin, ka paraqitur vetem katalog. Gjithashtu, eshte paraqitur vetem certifikate

konformiteti me e standardet e vendit ku kabli prodhohet, por OE nuk ka paraqitur test raport, ne menyre qe te kontrollohet perputhshmeria teknike e katalogut me parametrat e testuar;

3. mungon skeda teknike per kabllot e ushqimit he kontrollit, eshte paraqitur vetem katalogu. Kabllot e ushqimit dhe kontrollit te ofertuar nuk plotesojne standardet e kerkuara, perkatesisht standardet: Standardet: NF XP C32-321 NF C 15-100, EN 50575:2014 + EN 50575/A1:2016. Te gjithë kabllot e ushqimit dhe kontrollit te ofertuar, nuke tregojne ne asnje pjese te katalogut qe mund te punojne ne kushtet e kerkuara si me poshte:

Temperatura minimale e operimit (me demtime mekanike): -25 °C; Temperatura minimale e instalimit dhe perdorimit: -10°C; sic eshte kerkuar ne specifikimet teknike. Katalogu me titull "0.6/1kV Single Core Solar Cables" qe O ka paraqitur per te permbushur keto dy temperatura te instalimit dhe operimit nuk perfshin seksionet e kabllit te kerkuara ne kete procedure prokurimi pasi eshte vetem per percjelles me nje fije (1x) si dhe nuk ka izolacion XLPE.

OE nuk ploteson tensionet nominale dhe maksimale te punes per kabllot e kontrollit si me poshte:

a. Eshte kerkuar Tensioni nominal UO: 600V(AC), 1800V(DC), nuk eshte paraqitur vlere per tension UO.

b. Eshte kerkuar Tensioni nominal U: 1000V(AC), 1800V(DC) eshte ofertuar tension 0.6/1kV por nuk specifikohet nese eshte per tension AC apo DC. Nuke ploteson vleren per tension DC 1800V.

c. Eshte kerkuar Tensioni maksimal Um: 1200V(AC), 1800V(DC) eshte ofertuar tension 0.6/1kV. Same siper, kabli i ofertuar nga O per kabllot e ushqimit dhe kontrollit nuk permbushvleren maksimale te tensionit te punes per kabllot e kontrollit, si dhe nuk ka paraqitur vlere per tensionin e punes apo tensionin maksimal ne tension DC.

d. OE nuk ka paraqitur test raport per kabllot e ushqimit he kontrollit. Eshte paraqitur vetem certifikate konformiteti me e standardet e vendit ku kabli prodhohet, por OE nuk ka paraqitur test raport, ne menyre qe te kontrollohet perputhshmeria teknike e katalogut me parametrat e testuar.

OE nuk permbush piken 2.3.5 te KRITEREVE TE VECANTA TE KUALIFIKIM, celat e ofertuara nuk kane mundesi komunikimi me SCADA sips protokollit te komunikimit IEC61850. Celat e ofertuara nuk kane Rele qe sherben per mbrojtje dhe komandim ne distance. Per asnje nga celat e ofertuara, nuk jane paraqitur te dhena reth Releve, dhe gjithashtu nuk eshte cilesuar nese celat jane apo jo me rele mbrojtese qe te kene mundesi lidhje me SCADA sips protokollit te komunikimit IC 61850, sic eshte kerkuar ne specifikimet teknike.

Per kete arsye KVO vendosi te mos pranoje oferten e OE "EV ENGINEERING" shpk.

### **3. "RAFIN COMPANY " Sh.p.k**

**L52125110A**

1. OE nuk permbush piken 2.3.2 te KRITEREVE TE VECANTA TE KUALIFIKIMIT, per stafin:

1.1 OE nuk ka paraqitur diplome, kontrate pune dhe CV per Afroviti Koca ne pozicionin e Inxhinier Elektrik.

1.2. OE ka paraqitur deshmi kualifikimi "certifikate sigurimi teknik" vetem per ing. Afrodhiti Koca,por nuk ka paraqitur asnje dokumentacion sikurse eshte kerkuar nga AK ne piken 2.3.2 te DST si CV, Kontrate pune dhe deshmi kualifikimi per stafin elektrikist.

2. OE nuk permbush piken 2.3.5 te KRITEREVE TE VECANTA TE KUALIFIKIMIT.

2.1. Celat e ofertuara nuk plotesojne specifikimet teknike:

Tipi i celes eshte kerkuar: Celat duhet te jene me celes karroce he me rele mbrojtese qe te kene mundesi lidhje me SCADA sips protokollit te komunikimit IC 61850.; Celat e ofertuara nuk kane celes karroce, nuk kane rele dhe nuk kane mundesi komunikimi me SCADA sips potokollit te komunikimit IEC61850. Celat e ofertuara jane cela kabine, jo cela nenstacioni dhe nuk i plotesojne specifikimet teknike te kerkuara;

2.2 OE ka ofertuar dy prodhues te ndryshem dhe dy modele te ndryshme kablllo ushqimi dhe komandimi. Perkatesisht ka ofertuar kablllo ushqimi he kontrolli nga prodhuesi BORSAN he nga prodhuesl ICEL. Xjo bie ndesh me piken 2.15 te Njoftimit te Kontrates, ku eshte specifikuar qarte qe nuk pranohen variantet. Ne kete menyre KVO e ka te pamundur te vleresoje mbi specifikimet teknike te kablllove, pasi jane dy variante kablllosh ushqimi dhe komandimi;

2.3 Per kabllin e fuqise 6kV 1x70mm<sup>2</sup>, nuk ka paraqitur test raport. Ka paraqitur certifikate Konformiteti Standardesh te vendit ku kabli prodhohet, por nga kjo nuk mund te vertetohen parametrat teknik te kerkuar si dhe vlerat e matura gate testimit te kablllove. OE nuk permbush seksionin dhe numrin e dejeve te kabllit, eshte kerkuar kabell 1x70mm<sup>2</sup>, ka ofertuar kabell 3x185mm<sup>2</sup>.

Per kete arsye KVO vendosi te mos pranoje oferten e OE "RAFIN COMPANY" shpk .

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **"MUHOPLUS LTD " Sh.p.k**, me adrese "Rruga Ded Gjo Luli, Pallati Nr.2, Shkalla 2, Tirane , se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 14.727.060 (katermbedhete milion e shtateqind e njezet e shtate mije e gjashtedhete) lekë pa tvsh është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik".

**ADMINISTRATOR**  
**Olsi Isufaj**